



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**BASHKIA KORÇË**

Korçë më 18.01.2018

**RELACION**

**Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2018**

Bazuar në nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” çdo institucion i administratës shtetërore duke përfshirë edhe Bashkitë, përgatitin planin vjetor të nevojave për rekrutim në shërbimin civil. Në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duhet të parashikohen numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurimi për çdo kategori dhe klasë, numri i anëtarëve të TND ( trupa e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues) si dhe grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

Bazuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr.4 datë 05.01.2018 “ Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2018” numri i vendeve vakante, pjesë e shërbimit civil në Bashkinë e Korçës për këtë vit është 50. Nga këto pozicione 1 është vend vakant për nëpunës të kategorisë së lartë drejtuese ( drejtor drejtorie të përgjithshme), 4 janë vende vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie), 12 janë vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues ( përgjegjës sektori) dhe 34 janë vende vakante për nëpunës të nivelit egzekutiv (specialistë). Në këto kushte dhe bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” i propozojme Këshillit të Bashkisë Korçë të miratojë planin e punësimit të Bashkisë Korçë për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018 propozohet që numri i vendeve vakante për të cilat do të shpallet konkurimi të jetë si më poshtë:

- 1 vend vakant për nëpunës të nivelit të lartë drejtues (drejtor drejtorie të përgjithshme).
- 4 vende vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie)
- 12 vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues ( përgjegjës sektori) në pozicionet e mëposhtme:
- 33 vende vakante për nëpunës të nivelit egzekutiv (specialistë)

Rekrutimi i nëpunësve të nivelit të lartë e të mesëm drejtues dhe atyre të ulët drejtues bëhet nëpërmjet procedurës së levizjes paralele ose ngritjes në detyrë. Ndërsa përsa i përket nëpunësve të nivelit egzekutiv rekrutimi bëhet nëpërmjet konkursit për pranimin në shërbimin civil duke bërë klasifikimin sipas natyrës së pozicionit, në grupin e

pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm.

Referuar këtij klasifikimi në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm janë **3 vende vakante**, më konkretisht 1 specialistë për arkivat në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menxhimit të Burimeve Njerëzore ( Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkivës dhe shërbimeve Mbështetëse), 1 specialist në Drejtorinë e Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe Turizmit, 1 specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore ( Drejtoria e Kontroll Territorit). Këto pozicione klasifikohen në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm pasi kanë të bëjnë me të njëjtat përgjegjësi administrative në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil dhe ushtrimi i tyre kërkon njohuri të përgjithshme administrative. Ndërsa në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm janë 30 vende vakante. Këto pozicione klasifikohen në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm pasi kanë të bëjnë me përgjegjësi specifike në një apo disa institucione të shërbimit civil dhe ushtrimi i tyre kërkon njohuri të posaçme në një profesion të caktuar. Më konkretisht këto pozicione janë si më poshtë:

- 1 specialist për sektorin e rregjistrimit, 2 specialistë për kontrollin dhe mbledhjen e të ardhurave, 1 specialist për menaxhimin e borxhit të keq në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, gjithësej **4 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në një nga degët e Fakultetit të Ekonomisë.
- 3 specialistë për shërbimet veterinare në Njësinë Administrative Korçë, 1 specialist për shërbimet veterinare në Njësinë Administrative Bulgarec, Voskop, Voskopojë dhe Lekas si dhe 1 specialist për shërbimet veterinare Njësitë Administrative Drenovë, Mollaj dhe Vithkuq, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, gjithësej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në një nga degët e Fakultetit të Agronomisë dhe/ose Veterinarisë
- 2 inspektor i lartë auditimi në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, 1 specialist për të dhënat e konkurentëve dhe 1 specialist për blerjet e vogla në Drejtorinë e Prokurimeve, gjithësej **4 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimin në një nga degët e Fakultetit të Ekonomisë dhe/ose në Fakultetin e Drejtësisë. Pozicionet e inspektorëve të lartë të auditimit në Drejtorinë e auditit të Brendshëm duhet të jenë të çertifikuar si të tillë nga Ministria përkatëse.
- 1 specialist për shqyrtimin e lejavave të përdorimit, 1 specialist për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave demografike dhe 2 specialistë të tjerë në Sektorin për Administrimin e Rregjistrimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, si dhe 1 specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës etj gjithësej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme në fushën e urbanistikës, arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, topografisë etj
- 1 specialist/jurist dhe 1 specialist për menaxhimin e asteve në pronësi të Bashkisë Korçë, në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, gjithësej **2 pozicione** që kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Drejtësisë.

- 1 specialist në sektorin e pagesave në kesh, 1 specialist i ndihmës ekonomike për njësitë Administrative në Drejtorinë e Kujdesit Social, gjithësej **2 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Shkencave Sociale.
- 5 specialistë për bujqësinë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithësej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Agronomisë
- 3 specialistë pyjesh në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithësej **3 pozicione** i cili kërkon njohuri të posaçme dhe arsimim në fakultetin e Inxhinierisë së Mjedisit/ Pyjeve etj

Në zbatim të nenit 26 pika 4 e ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e mesme ose të ulët drejtuese, përveç procedurave të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë është i hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira të punës, duke mos kaluar 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik. Në këto kushte pasi të kenë përfunduar procedurat për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë propozojmë që të rekrutohen nga jashtë shërbimit civil nëpunësa për pozicionet e mëposhtme:

- Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës dhe të tjera.
- Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Drejtoria e Përgjithme e Taksave dhe Tarifave Vendore

**Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe  
E Menaxhimit Burimeve Njerëzore  
Anxhela Dishnica**

**KRYETARI**

**Sotiraq FILO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISË KORÇË**

**VENDIM**

Nr \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_

**Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për  
institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2018**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” dhe urdhërin e kryetarit të Bashkisë nr. nr.4 datë 05.01.2018 “Për miratimin e strukturës së Bashkisë Korçë për vitin 2018” dhe pas diskutimeve të këshilltarëve”

**VENDOSI:**

1. Te miratojë planin vjetor 2018 të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë
2. Numri i vendeve vakante për të cilat do të shpallet konkurimi të jetë 51 i ndarë sipas kategorive si më poshtë:
  - 1 vend vakant për nëpunës të nivelit të lartë drejtues (drejtor drejtorie të përgjithshme).
  - 4 vende vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie)
  - 12 vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues ( përgjegjës sektori) në pozicionet e mëposhtme:
  - 34 vende vakante për nëpunës të nivelit egzekutiv (specialistë)
2. Vendet vakante të nëpunësve të nivelit egzekutiv ( gjithësej 34 ) të klasifikuara sipas grupeve të administrimit të jenë si më poshtë:
  - 1 specialistë për arkivat në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menxhimit të Burimeve Njerëzore ( Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkivës dhe shërbimeve Mbështetëse), 1 specialist në Drejtorinë e Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe Turizmit, 1 specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave

dhe Tarifave Vendore ( Drejtoria e Kontroll Territorit), gjithësej **3 specialistë** të administrimit të përgjithshëm

- 1 specialist për sektorin e regjistrimit, 2 specialistë për kontrollin dhe mbledhjen e të ardhurave, 1 specialist për menaxhimin e borxhit të keq në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, gjithësej **4 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në një nga degët e Fakultetit të Ekonomisë.
- 3 specialistë për shërbimet veterinarë në Njësinë Administrative Korçë, 1 specialist për shërbimet veterinarë në Njësinë Administrative Bulgarec, Voskop, Voskopojë dhe Lekas si dhe 1 specialist për shërbimet veterinarë Njësitë Administrative Drenovë, Mollaj dhe Vithkuq, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, gjithësej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në një nga degët e Fakultetit të Agronomisë dhe/ose Veterinarisë
- 2 inspektor i lartë auditimi në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, 1 specialist për të dhënat e konkurentëve dhe 1 specialist për blerjet e vogla në Drejtorinë e Prokurimeve, gjithësej **4 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimin në një nga degët e Fakultetit të Ekonomisë dhe/ose në Fakultetin e Drejtësisë. Pozicionet e inspektorëve të lartë të auditimit në Drejtorinë e auditit të Brendshëm duhet të jenë të çertifikuar si të tillë nga Ministria përkatëse.
- 1 specialist për shqyrtimin e lejavave të përdorimit, 1 specialist për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave demografike dhe 2 specialistë të tjerë në Sektorin për Administrimin e Rregjistrimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, si dhe 1 specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës etj gjithësej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme në fushën e urbanistikës, arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, topografisë etj
- 1 specialist/jurist dhe 1 specialist për menaxhimin e asteve në pronësi të Bashkisë Korçë, në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, gjithësej **2 pozicione** që kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Drejtësisë.
- 1 specialist në sektorin e pagesave në kesh, 2 specialist i ndihmës ekonomike për njësitë Administrative në Drejtorinë e Kujdesit Social, gjithësej **3 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Shkencave Sociale.
- 5 specialistë për bujqësinë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithësej **5 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Agronomisë
- 3 specialistë pyjesh në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithësej **3 pozicione** i cili kërkon njohuri të posaçme dhe arsimim në fakultetin e Inxhinierisë së Mjedisit/ Pyjeve etj

4. Plotësimi i vendeve vakante të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues dhe atyre të mesëm e të ulët drejtues (gjithësej 17 ) të bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë
5. Përfshihen nga rregulli i përmendur në pikën 4 të këtij vendimi pozicionet e mëposhtme:
  - Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës dhe të tjera.
  - Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Drejtoria e Përgjithme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Rekrutimi i nëpunësve vetëm për këto dy pozicione do të kryhet nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil pasi të jenë ezauruar procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

6. Institucioni ku janë planifikuar vendet vakante është Bashkia Korçë
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe shpallet në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar dhe Punësimit dhe atë të Bashkisë Korçë.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Ilir BAJLOS**